



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission  
Prishtinë / Priština  
24-03-2020  
411/2020



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovë të datës 11.03.2020, për shpalljen e masave të nevojshme për përballimin e rrezikut nga situata epidemiologjike me COVID-19, si dhe bazuar në vendimin e Qeverisë e Republikës së Kosovës, të datës 13.03.2020, për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 24.03.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

### VENDIM

- I. Gjatë periudhës së masave të nevojshme për përballimin e rrezikut nga situata e krijuara epidemiologjike me COVID-19, anëtarët e KQZ-së mund të marrin vendime nga shtëpia apo vendndodhja jashtë zyrës, nëpërmjet komunikimit elektronik.
- II. Pas pranimit të agjendës, materialeve përcjellëse, anëtarët e KQZ-së përmes emailit, votojnë pro, kundër apo abstenim, për secilën pikë të rendit të ditës në një afat kur kërkohet nga pranimi i emailit.
- III. Kryetarja e KQZ-së, konstaton miratimin apo jo të propozim-vendimeve.
- IV. Marrja e vendimeve përmes emailit, do të zgjasin, deri në një vendim tjetër të KQZ-së.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ndodhur në rrethanat e krijuara për arsye të situatës epidemiologjike me COVID-19 në Kosovë, si dhe bazuar në vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovë, të datës 11.03.2020, për shpalljen e masave të nevojshme për përballimin e rrezikut nga situata epidemiologjike me COVID-19, dhe vendimin e datës 13.03.2020 për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID 19, në funksion të ndërmarrje së këtyre masave të nevojshme, vendosi që anëtarët e KQZ-së mund të marrin vendime nga shtëpia apo vendndodhja jashtë zyrës, nëpërmjet komunikimit elektronik, deri në një vendim tjetër të KQZ-së. Andaj, duke u bazuar në arsyet e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 24.03.2020

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

  
Valdete Daka, Kryetare